

INFORMACIONI STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KREDISË BLERJE DYQANI DHE TOKE

1. Emri dhe detajet e kontaktit të bankës

Banka	Banka Amerikane e Investimeve
Adresa	Rr. Kavajës, Nd.27, H.1, Nj.B.10, K.P.1001, Tiranë
Numri i Telefonit	+35542258755
Adresa postës elektronike	customercare@abi.al
Adresa e Web-it	www.abi.al

2. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë

2.1- Emri i Produktit	Kredi Hipotekare për Investim/ për qëllime tregtare					
2.2- Qëllimi i produktit	Kredi për blerje prone në emër individual me qëllim investimi, përfshirë blerje njësi tregtare, apartamenti për qira, blerje toke, investime afatgjata në pasuri me qëllime investimi. Kredia sigurohet me hipotekë mbi pronën e financuar ose një pronë tjetër të pranueshme nga banka.					
2.3-Lloji dhe Përshkrimi i produktit	Kredi e siguruar me garanci pasurie të paluajtshme. Ky produkt përdoret për qëllimin e parashikuar në pikën 2.2 dhe si garanci kërkohet objekti që do të blihet. Mund të pranohet kolateral i përkohshëm, kolateral i pranueshëm nga banka, hipotekë të pasurive të paluajtshme si apartament, ndërtesë, truall, tokë, dyqan. Shlyerja e kredisë do të kryhet me këste të barabarta mujore (kryegjë + interes) sipas aneksit të shlyerjes dhe jo si shlyrje e njëherëshme në fund të afatit të maturimit.					
	Monedha		Qëllimi		Financimi	DTI
	LEK	Blerje banesë e parë		85%	40%	
		Blerje banesë e dytë/ qiradhënie		80%	35%	
	EUR	Blerje banesë e parë		75%	35%	
		Blerje banesë e dytë/ qiradhënie		70%	30%	
	Të tjera	Emigrantët blerje apartamenti		60%	30%	
		Blerje njësi tregtare		60%	45%	
		Blerje trualli/toke		60%	45%	
2.4-Vlera totale e kredisë dhe monedha	- Kredia ofrohet në monedhat LEK / EUR dhe mund të jetë në të njëjtën monedhë ose në monedhë të ndryshme nga të ardhurat që gjeneron klienti. - Shuma maksimale e kredisë për blerje pasuri e paluajtshme është deri në EUR 1 milion (ekuivalenti në monedhën Lek) - Shuma minimale EUR 5,000 (ekuivalenti në monedhën Lek)					
2.5-Kohëzgjatja e kontratës së kredisë	6 Muaj deri në 20 vjet					
2.6- Kredia është në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat	a) Ne monedhe te ndryshme nga te ardhurat ☐ b) Ne te njeften monedhe me te ardhurat ☐					
2.7- Nese eshte e aplikueshme Vlera e keshtit të kredisë , e shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat , mund të ndryshojë	Ju do të merrni një njoftim në rastet ku, si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, kësti i kredisë _____ (i shprehur në monedhën që klienti gjeneron të ardhurat), tejkalon vlerën _____ (shuma në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, e cila është pothuaj 20% më e lartë se kundërvlera e kështit që do të rezultonte nëse do të aplikohet kursi i këmbimit midis monedhës së kredisë dhe monedhës në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat me datën e nënshkrimit të kontratës). Ju do të keni mundësinë të konvertoni monedhën e kredisë në (monedhën në të cilën gjeneroni të ardhurat), nëse plotësohen kushtet (_____).					
Shembull:	Skenari	Kursi i Këmbimit	Vlera e Kestit e shprehur ne monedhen e kredise (a)	Kundervlera e keshtit ne monedhen ne te cilen gjenerohen te ardhurat (b)	Te ardhurat (mesatarja mujore te 3 viteve te fundit) ne moendhen te cilat ato gjenerohen (c)	Raporti i vleres se keshtit ndaj te ardhurave (d) = (b) / (c)
	Kursi i kembimi nuk ndryshon	125	405	50,625	150,000	33.8%
	Nencmim i kursit te kembimit me 5%	131	405	53,156	150,000	35.4%
	Nencmim i kursit te kembimit me 20%	150	405	60,750	150,000	40.5%

2.8-Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve	Si kusht për lëvrimin e kredisë, Kredimarrësi do të hapë një llogari rrjedhëse pranë Abi Bank, e quajtur “llogaria e kredisë”, në të cilën Banka do të bëjë disbursimin e fondeve dhe nëpërmjet të cilës do të bëhet dhe ripagimi i kredisë. Kredia do të disbursohet me kërkesë të kredimarrësit në një ose me shumë transhe me kusht që klienti të ketë përmbushur kërkesat e bankës para lëvrimit të fondeve. Tërheqja e kredisë do të bëhet në një nga mënyrat: -a) me anë të tërheqjes në të holla;-b) me anë të tërheqjes me mjete elektronike;- c) me anë të një ceku të lëshuar nga vetë klienti mbi bankën;- d) me anë të urdhër-pagesës së dhënë me shkrim në favor të të tretëve. Kur gjatë disbursimit Banka konstaton se kredimarrësi ka dalë jashtë kushteve të parashikuara në Kontratën e kredisë nënshkruar nga palët, Banka ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kësaj kontrate që do të shoqërohet me kthimin e shumave të përdorura deri në atë moment dhe interesin përkatës.
2.9-Këstet dhe tabela e amortizimit të kredisë	Kredia paguhet në këste të barabarta mujore. Numri total i kësteve varet nga afati i maturimit. Kesti = Shuma e kryegjësë + Shumën e interesit e shpërndarë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kredisë, sipas planit të ripagimit. Plani i amortizimit të kredisë merret në degët tona sipas kërkesave të paraqitura nga klienti dhe kushteve të bankës në momentin e aplikimit. Plani i amortizimit nuk përbën detyrim ligjor as për klientin dhe as për bankën.
2.10-Shuma totale që konsumatori do të paguajë	Shuma totale që do të paguhet nga klienti në fund të maturimit të kredisë do të jetë: _____ (Vlera e akorduar e kredisë + interesat deri në fund të periudhës + kom.disbursimit + primet e policave të sigurimit)
2.11-Garanci/siguri të nevojshme	Per kredine per Shtepi , banka kerkon garanci: Kolateral Hipotekor;- Bashkekredimarres / Dorezanes ;-Kolateral Financiar. 1. Kërkohej garanci/kolateral hipotekor. Mund të pranohet kolateral i përkohshëm, ku si garanci e pranueshme nga banka konsiderohet hipotekë mbi pasuri të paluajtshme si: apartament, ndërtesë, truall, tokë, dyqan. Raporti i vlerësimit për pasurinë e paluajtshme kryhet nga vlerësues të pavarur të autorizuar nga Banka. Kosto e vlerësimit të garancise hipotekore mbulohet nga aplikanti. Në çdo rast vlera e mbulimit do të jetë: Ne rastin e kolateralit tipi “ambjent banimi”: - Mbulimi i vleres imediate e likuidimit të pasurisë do të jetë minimum 100% e vlerës së kredisë së akorduar; Ose - Mbulimi i vleres se tregut do të jetë minimumi 135% e kredisë së akorduar, nëse kolateral ofrohet ambjent banimi. - Ne rastin e kolateralit tipi “ambjent tregtar”, mbulimi i vleres se tregut të pasurisë do të jetë minimum 167% e vlerës së kredisë së akorduar. 2. Banka kërkon bashkëhuamarrës apo garantor për këtë kredi. Dorëzanësit garantojnë pa rezerva Bankën se do të përgjigjen me të gjithë pasurinë e tyre, për përmbushjen e detyrimeve totale që rrjedhin nga kjo Kontratë Kredie dhe ndryshimet e saj. 3. Cash collateral

3. Kostoja e kredisë

3.1-Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë. (tregon llojin e interesit dhe kohëzgjatjen e periudhës së përcaktuar)	Norma e interesit në fuqi për Investim/ për qëllime tregtare:				
		IR LEK	Min IR	IR EUR	Min IR
	1. Premier	Për vitin e 1 12M B.Th + 2.00% Në vazhdim 12M B.Th + 2.50%	3.50%	Për vitin e 1 12M Euribor + 3.00% Në vazhdim 12M Euribor + 3.50%	5.00%
	2. Pagamarrës/ qiramarrës	Për vitin e 1 12M B.Th + 2.50% Në vazhdim 12M B.Th + 3.00%	3.50%	Për vitin e 1 12M Euribor + 3.50% Në vazhdim 12M Euribor + 4.00%	5.00%
	3. Të ardhura nga biznesi	Për vitin e 1 12M B.Th + 3.00% Në vazhdim 12M B.Th + 3.50%	4.50%	Për vitin e 1 12M Euribor + 4.00% Në vazhdim 12M Euribor + 4.50%	5.50%
	4. Të ardhura të tjera / Emigrantë *	12M B.Th + 4.00%	5.50%	12M Euribor + 5.50%	6.00%
	* Për emigrantët ofrohet Kredi vetëm në monedhën EUR.				

3.2-Norma efektive e interesit (NEI)

Norma efektive e interesit (NEI) përcakton koston totale që klienti do të përballojë për kredinë e marrë, me kushtet që: kredia do të shlyhet për periudhën e rënë dakort, palët i përmbahen kushteve të përcaktuara në kontratë, interesi dhe shpenzimet e tjera mbeten të pandryshuara deri në fund të maturimit të kredisë. Norma efektive (NEI) shprehet si përqindje vjetore e vlerës së kredisë dhe përbëhet nga tërësia e shpenzimeve të klientit për marrjen e saj, duke përfshirë interesin e aplikuar, komisionin e disbursimit të kredisë dhe primet e sigurimit të jetës dhe të pronës të detyrueshme për tu paguar nga klienti. Për qëllime të llogaritjes se NEI totali i koston se kredisë nuk përfshin shpenzime që nuk njihen në datën e llogaritjes se NEI, shpenzime të pagueshme nga kredimarrësi të detyrimeve për moszbatimin e kushteve të parashikuara në kontratë, kostot e pagueshme nga kredimarrësi lidhur me marrëveshjen e kredisë për persona të tjerë (për shembull, tarifat noteriale, tarifat e Zyrove Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, tarifat e Regjistrimit të Barrëve Siguruese, të përcaktuara sipas akteve përkatëse).

Klienti do të informohet për normën efektive të interesit në momentin e aplikimit të kredisë : NEI do të jetë pjesë e kontratës së kredisë dhe gjithashtu në disbursimin e fondeve klienti do të pajiset me planin e amortizimit të kredisë.

Shembull

Perllogaritje e kështit te kredise per shtepi

Monedha EUR

Te dhënat	
Vlera e Kredise	100,000
Nomra e Interesit Viti I Pare	4.73%
Nomra e Interesit pas Vitit te Par	5.23%
Afati i Kredise	30
Primi I Sigurimit te Prones	80
Primi I Sigurimit te Jetes	70
Data e Fillimit te Kredise	16-Jul-26
Pagesa te tjera opsionale	0.00
Komision Disbursimi	1.00%
Komision mirembajtje llogarie	1.00

Permbledhje	
Kesti i kredise	521
Numri I pagesave	360
Shuma Tot. e Primit te Sigurimit te Prones	2,320
Shuma Tot. e Primit te Sigurimit te Jetes	2,030
Norma Periodike	0.44%
Data e Maturimit	16-Jul-56
Interesi Total	97,722
Shuma totale e komisionit te llogarise	360
NEI	5.636%

Nr Pagesave	Data e Pageses	Vlera ne Fillim	Komisioni i mirembajtjes se llogarise	Sigurimi Prones	Sigurimi Jetes	Kesti	Pagesa totale	Kryegjeja	Interesi	Vlera ne Fund
	16/07/2026						-	100,000.00		
	16/07/2026							1,150.00		
1	16/08/2026	100,000.00	1.00	-	-	520.44	521.44	126.28	394.17	99,873.72
2	16/09/2026	99,873.72	1.00	-	-	520.44	521.44	126.77	393.67	99,746.95
3	16/10/2026	99,746.95	1.00	-	-	520.44	521.44	127.27	393.17	99,619.68
4	16/11/2026	99,619.68	1.00	-	-	520.44	521.44	127.77	392.67	99,491.90
5	16/12/2026	99,491.90	1.00	-	-	520.44	521.44	128.28	392.16	99,363.62
6	16/01/2027	99,363.62	1.00	-	-	520.44	521.44	128.78	391.66	99,234.84
7	16/02/2027	99,234.84	1.00	-	-	520.44	521.44	129.29	391.15	99,105.55
8	16/03/2027	99,105.55	1.00	-	-	520.44	521.44	129.80	390.64	98,975.75
9	16/04/2027	98,975.75	1.00	-	-	520.44	521.44	130.31	390.13	98,845.43
10	16/05/2027	98,845.43	1.00	-	-	520.44	521.44	130.83	389.62	98,714.61
11	16/06/2027	98,714.61	1.00	-	-	520.44	521.44	131.34	389.10	98,583.26
12	16/07/2027	98,583.26	1.00	80	70	520.44	671.44	131.86	388.58	98,451.40
13	16/08/2027	98,451.40	1.00	-	-	550.22	551.22	121.14	429.08	98,330.27
14	16/09/2027	98,330.27	1.00	-	-	550.22	551.22	121.66	428.56	98,208.60
15	16/10/2027	98,208.60	1.00	-	-	550.22	551.22	122.19	428.03	98,086.41
16	16/11/2027	98,086.41	1.00	-	-	550.22	551.22	122.73	427.49	97,963.68
17	16/12/2027	97,963.68	1.00	-	-	550.22	551.22	123.26	426.96	97,840.42
18	16/01/2028	97,840.42	1.00	-	-	550.22	551.22	123.80	426.42	97,716.62
19	16/02/2028	97,716.62	1.00	-	-	550.22	551.22	124.34	425.88	97,592.28
20	16/03/2028	97,592.28	1.00	-	-	550.22	551.22	124.88	425.34	97,467.40
21	16/04/2028	97,467.40	1.00	-	-	550.22	551.22	125.42	424.80	97,341.98
22	16/05/2028	97,341.98	1.00	-	-	550.22	551.22	125.97	424.25	97,216.01
23	16/06/2028	97,216.01	1.00	-	-	550.22	551.22	126.52	423.70	97,089.49
24	16/07/2028	97,089.49	1.00	80	70	550.22	701.22	127.07	423.15	96,962.42
25	16/08/2028	96,962.42	1.00	-	-	550.22	551.22	127.63	422.59	96,834.79

3.3-Kosto shtese te pakthyeshme ne rastin kur aplikohen te tilla

Shpenzimet për raportin e vlerësimit të pasurisë/ve të ofruara si garanci variojnë në varësi të llojit të pronës që vlerësohet, rezidenciale, njësi biznesi, etj. Për kosto specifike referojuni formularit të transparencës në dispozicion pranë cdo banke.

Kosto e përmendur më lart klasifikohet si kosto para aprovimit dhe mbulohet nga klienti, pavarësisht vendimit përfundimtar. Kjo kosto është e pashmangshme për klientin dhe ofrohet nga ekspertë të autorizuar, jo nga Banka.

Raporti i vlerësimit për pasurinë e paluajtshme kryhet nga vlerësues të pavarur të autorizuar nga banka dhe kjo kosto mbulohet nga aplikanti. Në çdo rast vlera imediate e likuidimit të pasurisë do të jetë minimum 100% e vlerës së kredisë së akorduar ose vlera e tregut do të jetë minimumi 135% e kredisë së aprovuar, nëse kolateral ofrohet ambjent banimi. Nëse si kolateral ofrohet ambjent tregtar mbulimi duhet të jetë 167% e vlerës se kredise se akorduar sipas vlerës se tregut.

3.4-Kosto shtese te tjera.	1. Komision disbursimi -0% per blerje nga banka te tjera. -1% mbi shumën e kredisë. 2. Kostot e vlerësimit të pasurive të paluajtshme që do të vendosen si kolateral (ne varesi te prones) 3. Shpenzime Noteriale për kontratat e kredisë dhe të hipotekës. 4. Shpenzime për bllokim pasurie të paluajtshme pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme 5. Primi i polices se sigurimit te jetes ~ 0.45%-0.65% e shumës së kredisë (Varion nga shuma e kredisë, mosha dhe gjinia e aplikantit) 6. Primi i polices se sigurimit te prones ~ 0. 5%-1.2% e shumës së kredisë (Varion nga shuma e kredisë, mosha dhe gjinia e aplikantit) Në rast të ndryshimit të kushteve të kontrates së kredisë (me kërkesë të klientit) duhet të paguhet një komision prej 50 Eur/5,000 Lek. Kostot e mësipërme klasifikohen si kosto pas miratimit të kredisë. Këto shpenzime janë të pashmangshme dhe të detyrueshme para disbursimit të kredisë. Shpenzimet e hipotekimit, noterizimit të kontratave të kredisë dhe komisioni i disbursimit ekzekutohen vetëm një herë, ndërsa primet e sigurimit janë të pagueshme cdo vit, përvec rasteve kur klienti kryen pagesat për një afat tjetër të zgjedhur nga vetë ai.
3.5-Kosto ne rastin e pagesave ne vonese	- Në rast se Banka Zbulon që kredia nuk është përdorur për qëllimin e akorduar, atëherë ajo ka të drejtën që të kërkojë menjëherë ri-kthimin e kredisë dhe të interesave të akumuluar, - Në rast të mospagimit të interesit, Banka ka të drejtë të aplikojë një penalitet prej 25 (njëzet e pesë) % në muaj, i llogaritur mbi detyrimin e kështit të rradhës së pa paguar (kryegjë + interes) për periudhën në të cilën ai është në vonesë në bazë të kushteve të kësaj kontrate. Penaliteti do të llogaritet bazuar në ditë kalendarike, ku cdo muaj do të llogaritet në 30 ditë kalendarike. Përlllogaritja e penalitetit shembull : Kësti i radhës është 30,000 Lekë, Ditë në vonesë 5 ditë. Penaliteti për tu paguar = 30,000 Lekë x 25% x 5 (ditë në vonesë) / 360 ditë = 104 Lekë

4. Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore

4.1-E drejta për t'u tërhequr	Po ☐ Jo ☐ Huamarrësi ka të drejtën të tërhiqet nga kontrata e kredisë, pa dhënë arsye për këtë, brenda një periudhe 7 (shtatë) ditore nga momenti i lidhjes së saj, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Bankës. Ky afat fillon nga dita e nënshkrimit të kontratës ose nga data kur konsumatori merr dijeni për kushtet kontraktuale nëse kjo e fundit është e mëvonshme. Në rastet kur shuma e kredisë është disbursuar në llogarinë e klientit dhe ky i fundit ushtron të drejtën për tu tërhequr nga Kontrata e Kredisë, atëherë klienti pranon dhe merr përsipër të shlyejë kryegjënë dhe interesit për ditët perkatese, si dhe shpenzime të tjera të mundshme të bankës të krijuara me palë të treta për efekt të disbursimit të kësaj shume, mbi bazën e konfirmimit nga ana e Bankes te vlerës per t'u kthyer. Nese kredimarrësi tërhiqet nga kontrata e kredisë dhe bashkëkredimarrësi ose dorëzanësi gjithashtu, tërhiqet nga kontrata e kredisë ose tërheq garancinë/të e vendosura prej tij për ekzekutimin e kontratës.
4.2-Shlyerja (Pagesa) e kredisë para afatit të maturimit.	Huamarrësi mund të parapaguajë Huanë plotësisht apo pjesërisht duke njoftuar me shkrim Bankën në mënyrë të parevokueshme 14 (katërmëdhjetë) ditë pune përpara. Në këtë rast mbi shumën e ripaguar do të aplikohet një komision parapagimi, si më poshtë: - Parapagim do të konsiderohet vetëm shumat që janë minimalisht sa 6 këste mujore të kredisë - 1% (një përqind) të shumës së kredisë të paguar para afatit nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është më e vogël se 1 vit. - 2% (dy përqind) të shumës së kredisë të paguar para afatit nëse periudha midis shlyerjes para afatit dhe maturimit të kredisë është mbi 1 vit.
Mundesia e zevendesimit te sendit / pasurise (kolateralit)	Kolaterali mund të ndryshohet vetëm me marreveshje me shkrim të nënshkruar nga të gjitha palët në këtë Kontratë. Pasuria e re e ofruar si kolateral është subjekt i vlerësimit paraprak nga ana e Bankes dhe duhet të plotësojë të gjithë kërkesat ligjore lidhur me: - origjinin e rregullt të fitimit të pasurisë; - statusin e saj ligjor, pa kufizime apo mungesa në dokumentacion teknik të pasurisë; - kërkesat e tjera teknike (vendndodhja, sipërfaqja, vlera, etj.) lidhur me vlerësimin e saj në tregun e pasurive të paluajtshme.
4.3-Informimi në rast refuzimi të kredisë	Banka informon menjëherë konsumatorin në rast të refuzimit të kredisë duke i vënë në dispozicion arsyet mbi të cilat është bazuar ky refuzim.
4.4-Njoftimi zyrtar mes paleve	Të gjithë njoftimet, kërkesat apo komunikimet midis palëve do të bëhen me shkrim, nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit ose mesazheve telefonike si dhe nëpërmjet afishimit të njoftimeve ose broshurave në ambientet e bankës në faqen zyrtare të internetit ose në mjetet e komunikimit masiv dhe do të konsiderohen të njoftuara nëse dërgohen në adresat e palëve të deklaruar në Bankë. Banka duhet të njoftojë me shkrim, nëpërmjet mjeteve të qëndrueshme të komunikimit ose mesazheve telefonike, kredimarrësin për ndryshimet në kushtet e kontratës 30 (tridhjetë) ditë përpara aplikimit të ndryshimeve. Kredimarrësi deklaron dhe pranon që të gjithë llojet e njoftimeve të bëra në adresat e deklaruar do të konsiderohen si të marra nga ai. Kredimarrësi mund t'i paraqesë Bankës reklamimet e tij, për sa njoftohet, brenda një afati prej 15 ditësh kalendarike.

	Kredimarrësi është i detyruar që për cdo ndryshim në adresat e tij të njoftojë Bankën brenda 15 ditëve kalendarike për këtë ndryshim. Përsa kohë që ai nuk ka njoftuar adresën e re, Kredimarrësi nuk ka të drejte të kundërshtojë njoftimet e bëra në adresën e mëparshme.
4.5-Njoftim mbi përpunimin e të dhënave personale në lidhje me bashkëpunimin me autoritetet publike	Banka përpunon të dhëna personale të klientëve në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni bankar dhe financiar. Në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe për përmbushjen e detyrimeve ligjore, Banka mund të jetë e detyruar t'u vërë në dispozicion informacion autoriteteve publike kompetente, kur kjo kërkohej nga legjislacioni në fuqi, ose të një kërkesë zyrtare të këtyre autoriteteve. Në këtë kuadër, dhe në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e konkurrencës, Banka mund të transmetojë informacion dhe të dhëna edhe pranë Autoritetit të Konkurrencës, në rastet kur ky autoritet ushtron kompetencat e tij ligjore të monitorimit të tregut, në lidhje me veprimtarinë e bankës. Çdo përpunim apo transmetim i të dhënave personale, në këto raste, kryhet vetëm në masën që është i nevojshëm dhe proporcional, për përmbushjen e qëllimit të përcaktuar nga ligji, duke respektuar parimet e ligjshmërisë, minimizimit të të dhënave, konfidencialitetit dhe sigurisë së përpunimit. Banka merr të gjitha masat e nevojshme organizative dhe teknike, për të garantuar mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale të klientëve gjatë çdo procesi përpunimi ose transmetimi të tyre tek autoritetet publike kompetente.
4.6- Detyrimet e Kredimarrësit	Kredikërkuesi (aplikanti për kredi, overdraft apo kartë krediti) nuk do të ofrojë, premtojë, japë apo kërkojë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, asnjë dhuratë, pagesë, favor, përfitim apo avantazh të padrejtë për asnjë punonjës ose përfaqësues të Bankës, dhe nuk do të ndërmarrë asnjë përpjekje për të ndikuar në mënyrë të parregullt apo të paligjshme proceset vendimmarrëse të Bankës në lidhje me këtë kredi. Çdo formë e sjelljes agresive, kërcënuese, presionit apo tentativës për të fituar trajtim të padrejtë, e ushtruar nga Kredikërkuesi apo palët e lidhura me të, i jep të drejtën Bankës, sipas gjykimit të saj ekskluziv, të ndërpresë përpunimin e mëtejshëm të kërkesës për kredi dhe të refuzojë dhënien e kredisë apo disbursimin e saj.
4.7-Skema e brendshme e ankimit të konsumatorit kundrejt bankës.	-Ankesë me shkrim pranë cdo degë drejtuar Zyrës së Kujdesit për klientin, Rr. Kavajës, Nd. 27/1, K.P 1001, Tiranë -Vizitë pranë cdo dege ose agjensie . -Nepërmjet telefonit (Tel: 042258755-60) -Nepërmjet adresës elektronike Email: customercare@abi.al
4.8-Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor.	Ky informacion është i vlefshëm për një periudhë 7 ditore duke filluar prej nënshkrimit të këtij informacioni nga klienti. Gjatë kësaj periudhë kushtet e përcaktuara janë të pandyshueshme.

5. Shëmbull ilustrues për rrezikun e kursit të këmbimit për kredinë në monedhë të ndryshme nga ajo e gjenerimit të të ardhurave

5.1-Tekst sqarues për konsumatorin	Kredidhënia në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat për konsumatorin që nuk është i mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme. Për shëmbull një nënçmim i fortë i kursit të këmbimit do të shkaktonte vështirësi në aftësinë e konsumatorit për të shlyer kredinë. Këto vështirësi mund të çojnë në dështimin e konsumatorit për të shlyer kredinë; në kthimin e kredisë në statusin “me problem” dhe mund të përfundojnë në fillimin e procedurave për egzekutimin e detyrimit nga ana e bankës. Ky aneks përmban një shëmbull me nature ilustruese dhe informuese dhe nuk përfaqëson një pritshmëri apo angazhim ligjor nga kredidhënësi apo kredimarrësi. Konsumatori që aplikon për kredi në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat, nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti vërteton se : 1) e ka marrë këtë document nga banka përpara lidhjes së kontratës së kredisë; 2) e ka kuptuar shëmbullin dhe efektet e mundshme nga lëvizjet në kursin e këmbimit ; - 3) është i bindur që mund të përballojë rreziqet që shoqërojnë kredinë. Dokumenti i nënshkruar është pjesë e analizës që bën banka për dhënien e kredisë të konsumatorit por dokumenti i nënshkruar nuk e detyron bankën për dhënien e kredisë dhe as nuk e redukton përgjegjësinë që ka banka për të kryer analizën e saj të plotë, për qëndrueshmërinë financiare të aplikuesit për kredi.
5.2-Të dhënat për kredinë në monedhë të ndryshme nga monedha e gjenerimit të të ardhurave	Kredimarrësi: Kredidhënësi: Lloji kredisë: Kohëzgjatja e kredisë: Vlera e kredisë: Njesia,monetare: Kursi i këmbimit në datën e vlerësimit të planit ilustrues: Kundërvlera e kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat: Kesti i kredisë: Banka Amerikane e Investimeve Kredi per Investim/ qëllime tregtare 20 vjet 50.000 Eur Euro 125 (1Eur = 125 Leke) 6.250.000 Leke 299 Euro

	Norma efektive e interesit:	4.38%
	Indeksi orientues / normë reference :	Euribor 12M
	Marzhi:	3.8%
	Të ardhurat mujore (bruto / Neto) të huamarrësit në monedhen në të cilën gjeneron të ardhurat (mesatare e 3 viteve të fundit): 150.000 Leke	

_____/_____/_____
(Qyteti, dd, mm, vvvv)

(Klienti: Emër, Mbiemër, Firmë)